<b>2.8. Puna e dobishme shoqërore</b>	<p>Puna e dobishme shoqërore është formë themelore për zhvillim dhe stimulim të raportit pozitiv të nxënësve ndaj vlerave shoqërore, vlerave të jetës kolektive, nxitjes së ndjenjës së bashkësisë dhe përkatësisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm të natyrës. Këto aktivitete shkojnë në drejtim të përmirësimit të ambientit jetësorë dhe punues në shkollë dhe jashta shkollës.</p> <p>Në këtë kuptim, me programin e punës së shkollës, janë të parapara aktivitete në dobi shoqërore. Këto aktivitete do të realizohen në pajtim me rekomandimet shtetërore për aksionet masovike punuese por edhe në suaza të aktiviteteve të rregullta shkollore.</p>



	Në këto aksione me karakter të rëndësishëm shoqërorë do të marrin pjesë nxënësit, arsimtarët, kurse në forma të caktuara edhe personeli teknik i shkollës
<b>2.9 Eko aktivitete</b>	<p>Edhe këtë vit shkollor Shkolla vazhdon të merr pjesë aktive në programin “Eko shkolla” në suaza të së cilës janë të parapara disa aktivitete. Aktivitetet me të cilat do të realizohen aktivitetet nënkuptojnë inkuadrimit e të gjitha resurseve të pranishme në shkollë (nxënësit, arsimtarët, prindërit, shërbimi pedagogjiko – psikologjik, personeli teknik) si dhe bashkëpunimi me pushtetin lokal dhe bashkësinë afariste.</p> <p>Për këtë qëllim është përpiluar Plan ii aktiviteteve për integrim të edukimit ekologjik në sistemin arsimorë maqedonas për vitin 2022 / 2023 që duhet edhe formalisht të lidhet me programet arsimore (Shtojca nr.1)</p>
<b>2.10 Integrimi Multietnik në sistemin arsimorë</b>	Këtë vit shkollor, shkolla vazhdon aktivitetet e saj për integrimin multietnik në arsim. Planifikohen aktivitete me shkollën partnere SUGS "Arseni Jovkov". Gjithashtu, gjatë vitit shkollor do të realizohen tre punëtori në secilën klasë, gjithsej 108 punëtori me studentë nga të katër vitet. Punëtoritë përfshijnë tema që inkurajojnë tolerancën, bashkëpunimin dhe tejkalimin e stereotipeve në raport me bashkësi të ndryshme kombëtare dhe kulturore që jetojnë në Republikën e Maqedonisë, me qëllim të përmirësimit të komunikimit ndëretnik dhe tejkalimit të barrierave etnike, kulturore dhe gjuhësore. Realizimi i aktiviteteve do të jetë në pajtim me rekomandimet e MASH për punën e shkollës në kushte të pandemisë. (Shtojca Nr.2)
<b>2.11 Përcjellja dhe vlerësimi i suksesit dhe përparimit të nxënësve</b>	<p>Procesi mësimorë, për natyra e saj nënkupton realizimin e aktiviteteve me të cilat nxënësi do të përvetësoj dituri, do ti zhvilloj potencialet e veta, mendimin kreativ dhe kapacitetet krijuese. Në këtë kuptim, me planet arsimore ofrohen mundësi për realizimin e përmbajtjeve arsimore përmes zbatimit të formave dhe metodave arsimore. Prej evaluimit intern të shkollës, është evidente se nevojat intelektuale të nxënësve plotësohen me zbatimin e suksesit të metodave të ndryshme arsimore. Prej këtui, përcjellja dhe vlerësimi i suksesit dhe avansimit të nxënësve do të parashikohet në suaza të përgatitjeve ditore dhe tematike si dhe prej planeve vjetore për realizimin e procesit edukativo arsimorë.</p> <p>Gjatë vitit, arsimtari së paku dy hetë në një gjysmëvjetorë duhet të formuloj notën e nxënësit dhe publikisht tia kumtoj atij. Arsimtari, duhet të përgatis kritere të qarta të notimit, me të cilat do ti prezentoj mënyrat e notimit .</p> <p>Forma më të shpeshta për vlerësimin e nxënësve janë format e hartimeve (testet kontrolluese, listat arsimore, esetë e përpiluara, projektet etj.) si dhe mënyra gojore e verifikimit të diturive (përmes verifikimit gojor, aktivitetit gjatë orëve mësimore, bashkëpunimit në prezantimin e përmbajtjeve arsimore etj.).</p> <p>Arsimtarët i planifikojnë dhe koordinojnë terminet për verifikimet me shkrim dhe gjarisht të diturive të përvetësuara. Në këtë drejtim, në pajtim me kushtet dhe planifikimet dhe duke i pasur parasysh edhe vëllimin e madh të përmbajtjeve arsimore dhe ngarkesën e nxënësve, nuk realizohen më shumë se dy verifikime me shkrim për dituritë e nxënësve gjatë një jave.</p> <p>Suksesi i arritur i nxënësve përcaktohet nga ana e Këshillit të paraleleve të vitit, kurse kujdestari i klasës, përmes takimeve të rregullta prindore ose sipas nevojës u njofton prindërit e çdo nxënësi në veçanti.</p> <p>Në rast se jepen udhëzime për kryerjen e mësimdhënies në internet, mësuesit gjithashtu do të kryejnë testimin e njohurive dhe vlerësimin e njohurive të studentëve përmes përdorimit të teknologjisë në internet. Ata do të përdorin projekte, detyra,</p>

	teste, video, prezantime, etj, si metoda.
<b>2.12 Provimet</b>	<p>Në pajtim me dispozitat ligjore për organizimin dhe realizimin e provimeve në shkollë, dhe në varësi prej intereseve dhe kushteve të shkollës, në këtë vit shkollor do të organizohen këto forma të dhënies së provimeve:</p> <p><b>1. Provimet korrektuese</b> – për nxënësit që nuk kanë arritur sukses të mjaftueshëm në fund të vitit, për një ose dy lëndë mësimore. Afatet e provimeve: qershor dhe gusht.</p> <p><b>2. Provimet e vitit</b> për lëndë të caktuara – nxënësit do ti japin në dy afate të provimeve: qershor dhe gusht.</p> <p><b>3. Provimet plotësuese</b> – për ato nxënës që kalojnë prej programi në tjetrin të arimit të mesëm ose të fushës zgjedhore të arsimit gjimnazor. Nxënësi mund të jap vetëm një lëndë në një afat të provimeve. Afatet e provimeve: gusht, shtator, tetor (më vonë deri në fund të gjysmë vjetorit të parë).</p> <p><b>4. Provimet për nxënësit e çrregullt</b> – për ato nxënës të cilëve dispozitat ligjore u mundësojnë arsim të çrregullt. Afatet e provimeve: qershor, gusht, tetor, dhjetor, shkurt dhe prill. Në një afat të provimeve nxënësi mund të paraqesë së paku tre lëndë.</p> <p><b>5. Provimet e programeve fakultative</b> – për nxënësit që duan të japin programet me këto lloje të përmbajtjeve Afatet e provimeve: qershor dhe gusht.</p> <p><b>6. Provimet për avansim më të shpejtë të nxënësve</b> – për ato nxënës të cilët duan të përparojnë (tëprëfundojnë dy vite për një vit) dhe të cilët gjatë dy viteve të fundit kanë arritur sukses të shkëlqyeshëm.</p> <p><b>7. Provimet e maturës (matura shkollore dhe shtetërore)</b> – për nxënësit që përfundojnë arsimin e mesëm gjimnazor. Mënyrat e dhënies përcaktohen me dispozitat ligjore të MASH dhe EZHA të R.Maqedonisë në formë të provimeve eksterne dhe interne. Afatet e provimeve: qershor dhe gusht Provimet në shkollë (përveç provimeve të maturës eksterne) jepen para komisionit që është përgjegjëse për organizimin e suksesshëm të provimeve sipas dispozitave ligjore të përcaktuara me Ligjin për arsimin e mesëm</p>
<b>2.13 Sjellja e nxënësve</b>	Mënyra e përcaktimit të sjelljes së nxënësit është përcaktuara në dispozitat ligjore në Ligjin për arsim të mesëm dhe në Rregulloren për shqiptimin e masave pedagogjike të nxënësve dhe Statutin e shkollës
<b>2.14 Gara</b>	Në vitin shkollor 2022/2023, shkolla në mënyrë aktive do të marrë pjesë aktive në garat lokale, rajonale dhe shtetërore, sipas

	mënyrës dhe kushteve të përcaktuara nga organizatorët.
<b>2.15 Përsosja profesionale e kuadrit mësimdhënës</b>	Përsosja profesionale e arsimtarëve është me rëndësi të madhe për realizimin e procesit mësimorë cilësorë dhe modernë. Arsimtarët do të përfshihen në të gjitha trajnimet dhe seminarët e organizuara nga subjektet relevante me qëllim të sendërtimit permanent të diturive të tyre dhe zhvillimit të vetëdijes për mësim gjatë tërë jetës. Për këtë vit shkollorë janë të planifikuara trajnimet interne të arsimtarëve për shfrytëzim të smart tabelës, shfrytëzimin e projektorëve LCD dhe përpilimin e projekteve shkollore. Një pjesë e kuadrit mësimdhënës do të vijojë trajnime dhe diseminime në suaza të projekteve ekzistuese, kurse pjesa tjetër do të përsosin njohjen e gjuhëve të huaja (frenjisht, anglisht dhe gjermanisht) në suaza të programit ERAZMUS +programi.
<b>2.16 Plani për punën edukative të shkollës</b>	<p>Me realizimin e përmbajtjeve të veprimtarisë edukative arsimore të shkollës, realizohen edhe qëllime të procesit edukativo arsimorë bashkëkohorë. Përmes përpilimit të përmbajtjeve edukative arsimore që janë baza e procesit arsimorë, shkolla seriozisht bëhet pjesë e ndikimit edukativ mbi jetën dhe punën e nxënësve, por edhe të arsimtarëve.</p> <p>Prej prioriteteve që duhet të sigurojnë punë të suksesshme, këtë vit shkollor do të aktualizohen këto çështje:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Mbështetje për arsimtarët, nxënësit dhe prindërit në procesin e zbatimit të mësimin në internet pas krizës së shkaktuar nga Covid-19</li> <li>• Inkurajimi i një sensi të bashkësisë përmes të gjitha formave të punës ekipore</li> <li>• Përfshirje aktive e të gjithë mësuesve në krijimin e punës së shkollës</li> <li>• Krijimi i një klime pozitive dhe komunikimi në shkollë</li> <li>• Vendimmarrje me përgjegjësi të rëndësishme për punën e mësuesve dhe shkollës</li> <li>• Parimi dhe qëndrueshmëria në punë</li> <li>• Transparencë dhe demokraci më e madhe në operacione</li> <li>• Afirmimi i të drejtave dhe vlerave themelore të njeriut</li> <li>• Përmirësimi i zakoneve për kryerjen e rregullt të detyrave</li> <li>• Planifikimi i punës ditore dhe javore</li> <li>• Zhvillimi i vetëdijes për mirëmbajtjen e brendshme</li> <li>• Përmirësimi i shprehive të shëndetit dhe higjenës</li> <li>• Organizimi i veprimeve për rregullimin e ndërtesës së shkollës dhe oborrit</li> <li>• Puna në vetëvlerësimin integral të shkollës</li> <li>• Qasje neutrale gjinore në prezantimin e kushteve për regjistrim në shkollë.</li> </ul>
<b>III PRIORITETET E SHKOLLËS</b>	Prej rezultateve të deritanishme nga puna shumëvjeçare e shkollës, është fakt se ekzistojnë kushte reale për zhvillim të suksesshëm edhe në të ardhmen në të gjitha segmentet e punës. Me qëllim të vetëm që të vazhdohet tradita e punës së suksesshme si dhe me qëllim që të përcillen modelet e reja të arsimit, në këtë vit shkollor do të parashikohet realizimi i disa detyrave prioritare edhe atë:

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Realizimi i suksesshëm i procesit mësimor në kushte krize të shkaktuar nga Covid-19</li> <li>• Përdorimi i suksesshëm i teknologjisë online në realizimin e mësimdhënies</li> <li>• Përfshirje e suksesshme e të gjithë nxënësve në procesin arsimor</li> <li>• Rritja e qasjes së integruar në realizimin e përmbajtjeve mësimore</li> <li>• Përvetësimi dhe zbatimi i njohurive dhe aftësive të arsimtarëve dhe shërbimi profesional për të punuar me nxënësit me nevoja të veçanta arsimore.</li> <li>• vazhdimi i trendit të përfshirjes së prindërve dhe komunitetit lokal në punën e shkollës në forma të ndryshme.</li> <li>• Përfshirje më e madhe e nxënësve në procesin e vlerësimit dhe marrjen e përgjegjësisë për suksesin e tyre.</li> <li>• Bashkëpunim më i mirë për barazimin e kriterëve të arritjeve të studentëve në kuadër të aktiviteteve profesionale dhe përdorimin e metodave të ndryshme të mësimdhënies dhe formave të vlerësimit të punës së nxënësve dhe harmonizim më të madh të standardeve për vlerësim në nivel të pasurive profesionale.</li> <li>• Qasje e integruar ndaj mësimdhënies.</li> <li>• Gjetja e metodave më efektive për të zvogëluar mungesat.</li> <li>• Zhvillimi i një sistemi të strukturuar për monitorimin e nevojave emocionale, sociale dhe fizike të nxënësve</li> <li>• Përmirësimi dhe pasurimi i kushteve materiale dhe teknike në shkollë.</li> <li>• Prioritetet e shkollës do të përshtaten në përputhje me kushtet e punës në një pandemi dhe rekomandimet e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.</li> </ul>
<b>3.1. Puna transparente dhe informimi më i madh</b>	<p>Njëri prej prioriteteve kryesore të shkollës është informimi më i madh i të gjitha strukturave brenda dhe jashta shkollës. Në këtë kuptim, vendimet e Drejtorit dhe shërbimeve profesionale, me rregull do të kumtohen në tabelën e shpalljeve të shkollës (zyrja e arsimtarëve). Drejtori i shkollës, rekomandimet e veta dhe Informaconet e përgjithshme për shkollën, me rregull di ti kumtoj në informatorin shkollorë, si dhe në ueb faqen e shkollës sonë.</p> <p>Sa i përket mësimin në distancë, mësuesit komunikojnë përmes platformës elektronike, Mc Teams dhe Zoom në mënyrë që të informojnë dhe zbatojnë rregullisht aktivitetet.</p>
<b>3.2. Përmirësimi i rregullsisë në procesin mësimorë</b>	<p>Në këtë vit shkollor do të vazhdohet me punët e praktikave pozitive në fushën e përmirësimit të rregullsisë në procesin mësimorë përmes metodave parandaluese dhe zhvillimin e mënyrave dhe formave të reja të ballafaqimit me këtë problem. Kurse do të implementohen edhe metodet e reja me qëllim që të krijohet model më i përshtatshëm për punë me nxënësit dhe prindërit për tejkalimin e gjendjes me mungesë nga mësimi.</p> <p>Sa i përket mësimin në distancë, praktika nga viti i kaluar shkollor do të zbatohet për komunikim të rregullt me nxënësit dhe prindërit që nuk janë gjithmonë të rregullt në klasa, si dhe sigurimin e tabletave për ata nxënës që nuk janë në gjendje të sigurojnë vetveten.</p>
<b>3.3 TK në procesin mësimorë</b>	<p>Në vitin akademik 2021/22, zbatimi i KT në procesin mësimor do të vazhdojë me qëllim të pasurimit të njohurive të nxënësve dhe inkurajimit të potencialeve të tyre krijuese si një nga qëllimet themelore në procesin arsimor. Janë të pajisura 17 klasa me projektorë LCD, 8 me TV SMART, 9 klasa me bord inteligjent dhe 3 klasa me gjithsej 54 kompjuterë për studentë, të cilat do të përmirësojnë procesin arsimor.</p>

	Nëse është e nevojshme, nëse mësimi vazhdon të zhvillohet me mësim në distancë (online), shkolla do të ofrojë ndihma dixhitale që do të lehtësojnë procesin mësimor.
<b>3.4 Drejtimi i evidences pedagogjike</b>	Këtë vit shkollorë, dot ë punohet në përmirësimin e drejtimit të dokumentacionit pedagogjik në trajtë të forët dhe elektronike. Ditari i punës do të drejtohet në trajtë elektronike sipas udhëzimeve nga MASH.
<b>3.5. Forma të shoqërimit të nxënësve</b>	Në shkollat ekziston praktika afatgjate e shoqërimit të nxënësve, përmes cilës nxënësit kanë mundësi që të prezantohen përmes formave të ndryshme. Forma e posaçme e shoqërimit të nxënësve dhe Parlamenti i nxënësve në të cilën organizohen mbledhje të rregullta në lidhje me çështjet aktuale dhe problemet dhe abshkëpunojnë me strukturat e shkollës. Gjithashtu do të vazhdohet me punë edhe Bashkësia e nxënësve përmes cilës nxënësit do të ndikojnë mbi përmirësimin e procesit edukativo arsimorë. (Shtojca nr.12)
<b>3.6. Zmadhimi i sigurisë në shkollë</b>	Ky vit shkollor do të vazhdojë me realizimin e aktiviteteve në fushën e parandalimit dhe trajtimit të dhunës. (Shtojca Nr. 3)
<b>3.7. Qasja e integruar në procesin mësimorë</b>	Në vitin shkollor 2022/2023, do të bëhet punë intensive në rritjen e numrit të klasave të realizuara ndërmjet lëndëve të ndryshme, pra qasje të integruar në procesin arsimor. Përvojat pozitive do të vazhdojnë të realizohen në të ardhmen.
<b>3.8. Krijimi i platformës kolaborative</b>	Në vitin shkollor 2022/2023 theks i veçant do ti jepet krijimit dhe ngjalljes së platformës kolaborative për shkëmbim të informacioneve dhe materialeve të cilat u nevojiten arsimtarëve për realizim të suksesshëm të procesit mësimor. Po ashtu do të vazhdohet me punën përmes shfrytëzimit të rrjeteve sociale dhe on line grupeve diskutuese për komunikim me arsimtarët, nxënësit dhe prindërit.
<b>3.9. Procedura për procesin e përpunimit, ruajtjes së të dhënave personale</b>	Në vitin shkollor 2022/23 Theks i veçantë do t'i kushtohet zbatimit të aktiviteteve për grumbullimin, përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave personale të studentëve (portofoli i studentëve) si dhe ndjekjen e procedurës së mbrojtjes së të dhënave në rast të përdorimit të mediave sociale, pra zbatimin e një procedure të përgatitur për mbrojtjen e të dhënave personale është një bazë elektronike e të dhënave për nxënësit në shkollë.
<b>3.10 Shkolla inkluzive</b>	Në vitin shkollor 2022/2023. Theksi do të vihet në prezantimin e parimit gjithëpërfshirës në procesin arsimor, duke përgatitur një ekip për përfshirje dhe përgatitjen e planeve arsimore afatgjata dhe individuale për studentët nëse ka raste të nxënësve me programe arsimore speciale në shkollë.
<b>3.11 Përsosja profesionale e kuadrit mësimdhënës</b>	Në vitin shkollor 2022/2023. Zhvillimi profesional i stafit mësimor do të inkurajohet dhe mbështetet, duke përgatitur plane personale për zhvillimin profesional të mësuesve dhe duke organizuar dhe realizuar trajnime të përshtatshme për mësuesit.

<b>IV PROJEKTE QË DO TË REALIZOHEN GJATË VITIT SHKOLLORË 2020/21</b>	<p>Shkolla do të vazhdojë të zhvillojë bashkëpunimin ndërkombëtar në nivelin shtetëror, institucional dhe të projektit përmes bashkëpunimit me shkollat dhe universitetet. Nëpërmjet veprimtarive, projektet ushqejnë dhe zhvillojnë karakteristikat individuale të personit, përmes proceseve të njohjes, të kuptuarit dhe respektimit të kulturave të tjera, në një nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, në mënyrë që të krijojnë të rinj me pikëpamjet, interesat dhe motivet e tyre.</p> <p>Nëse rekomandimet ekzistuese për zbatimin e mësimin në internet mbeten, aktivitetet do të adaptohen në varësi të kushteve dhe përmbajtjes së projekteve.</p>

Nr.rend	Titulli i Projektit	Arsimtari përgjegjës	Koha e realizimit
1	Festivali i Shkencës, Beograd	Elizabeta Nikolovska	dhjetor 2022
2	Takimet e 6 të shkollave të mesme të Evropës	Mitko Dimovski Suzana Tnokova - Kuzmanovska Ana Poprizova Suzana Duleska Pavlina P. Sterjovski	Mars 2023
3	"Shkollat e sigurta - mjedis harmonik" - HERA dhe Qyteti i Shkupit	Ana Poprizova Angelina Maksimovska	Gjatë gjithë vitit

4	Kompensimi monetar i kushtëzuar	Angelina Stevkovska Maksimovska	Gjatë gjithë vitit
5	Maji është muaji i maturantëve	Aneta Gligorova Bogolub Lloshevski	Maj
6	Plan kreativ biznesi për sipërmarrës të suksesshëm	Pavlina Shterjovski	Dhjetorë
7	Integrimi multi-etnik në arsim zbatohet nga USAID, në bashkëpunim me Qendrën Maqedonase për Edukim Qytetar (QKZE)	Angelina Stevkovska Maksimovska; Suzana Çerepnalkovska; Snezhana Krstevska; Viktorija Dokaza; Aneta Gligorova	Gjatë gjithë vitit
8	"Opera dhe baleti në vendet fqinje"	Susanna Tnokova Susana Duleska Mirjana Bogdanoska Pavlina Shterjovski	Gjatë gjithë vitit
9	Ditë e hapur e shkollës	Pavlina Shterjovski	Prill 2023
10	Shkenca dhe arti në vendet evropiane	Susana Duleska Pavlina Sterjoski Susanna Tnokova	Tetor - Nëntor 2022, mars 2023

		Kuzmanovska	
11	estivali i filmit për audiencë të re "Jifoni Maqedoni"	Radica Milkovska	Tetorë 2022
1 2	"Kujdestarët e Mjedisit Ndërkombëtar" (Prezantimi i Projektit të Konferencës Vjetore)	Katerina Haxhi-Iloska Spirkovska	Tetor 2022 – Korrik 2023
1 3	Projekti NMC	Violeta Toleva	11.2022-02.2023
1 4	Mësoni të bëni ski" (Bullgari)	Antonio Konevski	01.2023
1 5	Shkëmbim me shkollën e Unës, Gjermani 2022/2023	Violeta Toleva ElizabetaPopovska	Gjatë tërë vitit
1 6	Bashkëpunim dhe shkëmbim me gjimnazin "Polyane" nga Lubjana, Slloveni	Dragica Jankullovska Mitko Dimovski	Gjatë tërë vitit
17	Projekti "Shkenca dhe Astronomia", Selanik, Greqi	ElizabetaPopovska ZoranIvanovski	02. 2023
18	Projekti ERASMUS + "Turn the Switch".	Anastasia Belevska	Gjatë tërë vitit
19	Bashkëpunim me Shkollën Baudelaire, Roubaix, R. Francë (shkëmbim	Anastasia Belevska	Gjatë tërë vitit



	shkollor)	Susanna Stojçevska Jasmina Ivkovska Susana Dulevska Milica Mitrevska	
2 0	Bashkëpunimi me shkollën Pirot, Pirot, R. Serbia (shkëmbim shkollor)	Anastasia Belevska Susanna Stojçevska Jasmina Ivkovska Susana Dulevska Milica Mitrevska	Gjatë gjithë vitit
2 1	"Qëndrimi gjuhësor në Antibes, R. Francës	Anastasia Belevska Susanna Stojçevska	Gjatë gjithë vitit
2 2	Projekti Erasmus + Shkëmbim kulturor me Turqinë, Serbinë, Spanjën, Greqinë dhe Italinë. "Ne po shkëmbejmë kultura nga mjetet Web2"	Biljana Jovaçeva	Gjatë gjithë vitit
2 3	Projekti Erasmus + – "SHARKS – Heronjtë e Qëndrueshmërisë dhe Kalorësit e Paqetë në Shkolla". 2020-	Biljana Jovaçeva	Gjatë gjithë vitit

	2023		
24	Teatri bashkon të rinjtë e Ballkanit	Susana Cherepnalkovska Ljupka Bocevska	02. 2022
25	Projekti ERASMUS + "Kovid 19"	Suzana Stojçevska	Gjatë gjithë vitit
26	Takimi i të parëve me më të mirët, Drejtorja e Kulturës dhe Arteve	Anna Poprizova Angelina S. Maksimovska	Qershorë
27	Vizitë në teatër – Përjetimi i teatrit jashtë kufijve të vendit	Dragica Jankullovska	Gjzsmëvjeteri u pare dhe I dytë
28	Përjetimi i punës së Trojës dhe Homerit nga këndvështrimi i lexuesit të shekullit të 21-të	Susana Cherepnalkovska Ljupka Bocevska	Nëntorë 2022
29	Lojërat e shkollës së mesme 2022, SFERE	Anna Poprizova Angelina S. Maksimovska	Shtatorë - tetorë
30	"Jo dhunës" - Fondacioni Qendra Memoriale "Nikola Kljusev".	Anna Poprizova Angelina S. Maksimovska	Shtatorë-nëntorë
31	"Më pyesni, më dëgjoni, më kuptoni" - Shoqata e qytetarëve për iniciativën kulturore dhe arsimore "Reverance" -	Anna Poprizova Angelina S. Maksimovska	Shtatorë-dhjetorë

	Shkup		
32	Shëndeti mendor i të rinjve - Mozaik Meik	Anna Poprizova Angelina S. Maksimovska	Shtatorë -dhjetorë
33	Me biçikletë dhe skuter kudo në Shkup - Shoqata për motivim kulturor KULTI VATOR Shkup	Profesorët e sportit dhe aktiviteve sportive	Shtatorë-nëntorë
34	Ne ndërtojmë Eko-ndërgjegjësim - ZG për realizimin dhe promovimin e të drejtave të njeriut, zhvillim të qëndrueshëm lokal dhe rural dhe pranim të diversitetit kulturor Uniteti i komuniteteve - Shkup	Ljubisha Gabrovski Elena Mingovska Elena Stefanovska	Maj-dhjetor
35	3D Spectrum - Ainovum Shkup	profesorët e informatikës	shtatorë-dhjetor
36	Përmes lenteve shëndetësore - me edukim për jetëgjatësi dhe mënyrë jetese të shëndetshme - 3D Fenix AID Skopje	Ana Poprizova Angelina S Maksimovska	shtatorë-dhjetor
37	Një komunitet premtues në luftën kundër dhunës - Parlamenti Studentor i FINKI	Ana Poprizova Angelina S Maksimovska	shtatorë-dhjetorë

38	Mbeturinat elektronike dhe menaxhimi i duhur - Vake up Shkup	Ana Poprizova Angelina S Maksimovska	shtatorë-dhjetorë
39	Nxënës të shkollave të mesme për Qendrën e-Vullnetare të Shkupit të pastër Shkup	Ana Poprizova Angelina S Maksimovska	shtatorë-dhjetorë
40	Forca, jo dhuna – Qendra Kreative Trintiri Mintiri	Ana Poprizova Angelina S Maksimovska	shtatorë-dhjetorë
41	Më e zhurmshme – një iniciativë e komunitetit studentor	Ana Poprizova	Shtator-tetor 2022
42	Mbrojtje nga zjarri	Mitko Dimovski	Shtatorë

<b>V KALENDARI I PUNËS GJATË VITIT SHKOLLORË 2021/22</b>	Shkola do të punojnë sipas kalnedarit të përcaktuar nga MASH dhe EZHA i njëjti do të jetë si shtojcë i këtij programi.
<b>5.1 Takime prindore</b>	<b>Takimet prindore</b> janë të parapara terminet vijuese:  <ul style="list-style-type: none"> <li>- takimi i parë prindor në javën e tretë të shtatorit</li> <li>- takimi i dytë prindor në javën e dytë të nëntorit</li> <li>- takimi i tretë prindor në muajin janar</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- takimi i karërt prndor në javën e parë të muajit prill.</li> <li>- takimi i pestë prndor, pas përfundimit të vitit shkollor.</li> </ul> <p>Sipas nevojës do të realizohen edhe takime të çrregullta me prindërit për ato paralele që tregojnë rezultate të dobëta ose ballafaqohen me probleme të caktuara. Nëse mësimi realizohet online, atëherë shkolla do të ofrojë kushte edhe për zhvillimin e takimit prindëror duke përdorur teknologjinë dixhitale.</p>
<b>5.2 Këshillime të prindërve dhe nxënësve</b>	Në pajtim me Ligjin për arsim të mesëm, shërbimi pedagogjik – psikologjik do të organizoj këshillime të vazhdueshme me prindërit dhe nxënësit me plane mujore të përgatitura dhe prezantime të temave të caktuara.
<b>5.3. Plani për realizim të veprimtarisë kulturore të shkollës</b>	<p>Pranimi solemn i nxënësve të viteve të para</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Shënimi i 8 Shtatorit – Ditës së shpalljes së pavarësisë së Republikës së Maqedonisë</li> <li>- Shënimi i 11 Tetorit – Ditës së kryengritjes së popullit maqedonas</li> <li>- Shënimi i 23 Tetorit – Dita e Luftës revolucionare të Maqedonisë</li> </ul> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Shënimi i 13 Nëntorit – Çlirimi i Shkupit</li> <li>- Pritja e organizuar e Vitit të Ri</li> <li>- Shënimi i 8 Marsit – Dita e gruas</li> <li>- Shënimi i Ditës së patronatit të shkollës 23.03.2022</li> <li>- Shënimi i Ditës së ekologjisë dhe pjekurisë (21 marsi dhe 22 prilli)</li> <li>- Shënimi i Një majit – Dita e punës</li> <li>- Shënimi i 24 majit – Dita e arsimuesve sllav Qirili dhe Metodi</li> <li>- Pritja e organizuar e mbrëmjes së maturës</li> <li>- Ndarja solemne e diplomave dhe shpërblimeve për nxënësit e viteve përfundimtare</li> <li>- Ndarja e organizuar e dëftesace për nxënësit</li> </ul>
<b>VI. ORGANET DHE TRUPAT DREJTUESE DHE PROFESIONALE</b>	
<b>6.1 Drejtori</b>	<p>Drejtori është organi udhëheqës i shkollës dhe është përgjegjës për respektimin e ligjshmërisë në funksionimin e shkollës, kujdeset për statusin dhe pozitën e të punësuarve, e organizon dhe drejton punën edukativo arsimore, në mënyrë të pavarur miraton vendime, e përfaqëson shkollën para personave të jashtëm.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- E propozon programin vjetor për punën dhe ndërmerr masa për realizimin e saj;</li> <li>- I realizon vendmet e Këshillit shkollor;</li> <li>- Në menzrë direkte drejton me shkollën</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- e organizon punën edukativo-arsimore</li> <li>- Kryen përcaktimin e kujdestarëve të klasave dhe të orëve</li> <li>- Përpilon një propozim plan për furnizime publike si dhe plan financiar dhe po të njëjtat i dorëzon deri te KSH në miratim</li> <li>- Kryen zgjedhjen e arsimtarëve dhe bashkëpunëtorëve profesional si dhe të kuadrit tjetër administrativo-teknik;</li> <li>- Vendos për përcaktimin e arsimtarëve, bashkëpunëtorëve profesional dhe punëtorëve si dhe kryen notimin në pajtim me rezultatet e punës së tyre;</li> <li>- dorëzon raport për suksesin dhe për rezultatet e arritura në punën edukativo arsimore deri te Enti pedagogjik i Maqedonisë</li> <li>- vendos për pushimin e marrëdhënies së punës për të punësuarit si dhe të kuadrit tjetër administrativo-tekni ;</li> <li>- dorëzon raport për realizmin e programit vjetor deri te Qyteti i Shkupit;</li> <li>- Lidh kontrata, nënshkruan dëftesa, vendime, urdhëresa dhe akte të tjera në pëlqim me ligjin</li> <li>- lejon mungesët e të punësuarve dhe nxënësve</li> <li>- përcakton zëvendësimin e punëtorëve që mungojnë befasisht</li> <li>- udhëheq dhe drejton me seancat e NS si dhe në mënyrë aktive merr pjesë në punën e organeve të tjera profesionale të shkollës</li> <li>- emërton person me autorizime të veçanta</li> <li>- zgjedh komisione nën ingjerenat e tij</li> <li>- jep lajmërimet dhe urdhëresa</li> <li>- sjell vendime në mënyrë të pavarur nga fushëveprimi i përgjegjësive të tij të konstatuar me ligj dhe me dispozita të tjera si dhe me aktet e përgjithshme të shkollës</li> <li>- paraqet dhe prezanton shkollën para personave të tretë</li> <li>- kujdeset për kryerjen e punëve në harmoni e ligjin si dhe për zbatimin e ligjeve, dispozitave tjera, statutit dhe akteve të tjera të shkollës</li> <li>- dorëzon raport për punën materiale të shkollës deri te Këshilli drejtues dhe komuna</li> <li>- kryen mbykqyrje instruktive –pedagogjike në shkollë</li> <li>- kujdeset për rendin dhe disiplinën në shkollë</li> </ul> <p>- realizon edhe detyra të tjera sipas nevojës;</p> <p>Planin vjetor për punën e Drejtorit për vitin shkollorë 2021/22 është dhënë si shtojcë e Programit vjetor të Programit të punës së shkollës. <b>(shtojca numër 5)</b></p>
<p><b>6.2. Drejtuesi i proc. mësimorë</b></p>	<p>Në shkollë punojnë dy drejtues të procesit mësimorë, përgjegjës për ndërrimet. Ata i ndihmojnë Drejtorit në organizimin dhe përcjelljen e punës për vitet përkatëse. Ata e organizojnë procesin e punës në pajtim me programin dhe planet e punës së shkollës; drejtojnë me njësitin punues; e koordinojnë punën e kujdestarëve</p>

	<p>të klasës dhe arsimtarëve; kujdesen për rregullsinë dhe disiplinën e arsimtarëve dhe nxënësve, e organizojnë dhe përcjellin punën e këshilave klasore, mësimin plotësues dhe shtues, e përcjellin punën e organizatave shkollore, bashkëpunojnë me nxënësit dhe prindërit; marrin pjesë dhe i ndihmojnë organizimit të provimit korrektuese dhe përfundimtare.</p> <p>Plani vjetor për punën e drejtuesve të procesit mësimorë gjatë vitit shkollor 2021 / 2022 është dhënë si shtojcë e programit për punën e shkollës. (Shtojca numër 6)</p>
<b>6.3. Këshilli i shkollës</b>	<p>Këshilli shkollor është një organ i udhëheqjes së shkollës.</p> <p>Ky numëronm tre anëtarë edhe atë: 4 përfaqësues nga arsimtarët, 3 përfaqësues të prindërve të nxënësve, 3 përfaqësues të themeluesit dhe me nga një përfaqësues nga MASH dhe bashkësia afariste (Oda Ekonomike). Këshilli i shkollës miraton:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Statusin</li> <li>- Programin dhe raportin vjetor të punës</li> <li>- Propozon planin vjetor financiar deri te Ministria, propozon llogarinë përfundimtare</li> <li>- Miraton planin vjetor për furnizime publike</li> <li>- Shpall konkurs për zgjedhje të drejtorit,</li> <li>- Vendos për ankesat dhe parashtresat e të punësuarve, nxënësve dhe prindërve</li> <li>- Shqyrton edhe çështje të tjera të përcaktuara me Statutin e Shkollës.</li> </ul> <p>Anëtarë të KSH: Themelues: Sllavço Stojanovski, Aco Spasenovski dhe Olivera Pehçevska MASH: Donka Ristovska Prindërit: Zoran Cokovski, Daniela Panajotova, anëtari i ri do të zgjedhet më 09.2022 (shtojca numër 7)</p>
<b>6.4. Këshilli i prindërve</b>	<p>Në shkollë ekziston edhe këshilli i prindërve të cilin e përbëjnë përfaqësuesit e prindërve që nuk janë të punësuar në shkollë. Këshilli i prindërve e përcjell procesin mësimorë, jep mendime për realizimin e punës edukativo arsimore. Puna, numri i anëtarëve të këshillit si dhe mënyra e zgjedhjes dhe organizimi i këshillit të prindërve përcaktohet me Statusin e shkollës.</p> <p>Shtojca nr. 17</p>
<b>VII . ORGANET DHE TRUPAT PROFESIONALE</b>	<p>Organet dhe trupat profesionale të shkollës janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Këshilli i arsimtarëve</li> <li>- Këshilli i vitit</li> <li>- Këshilli i paraleles</li> <li>- Aktivat profesionale</li> </ul>

<b>7.1. Këshilli i arsimtarëve</b>	Këshillin e arsimtarëve e përbëjnë arsimtarët dhe bashkëpunëtorët profesional në shkollë. Këshilli i arsimtarëve jep mendime për propozimin e Programit të punës dhe e përcjell realizimin e tij, e shqyrton dhe konstaton suksesin e nxënësve si dhe punën e organeve dhe trupave tjera profesionale, shqipton masa pedagogjike për nxënësit, formon aktiva profesionale, komisione, këshilla të provimeve, regjistrimin e nxënësve në vitin e parë, shqyrton kërkesat dhe ankesat e nxënësve dhe prindërve.
<b>7.2. Këshilli i vitit</b>	e përbëjnë arsimtarët që realizojnë mësim në vitin përkatës dhe bashkëpunëtorët profesiona. Këshilli i vitit e organizon procesin mësimorë dhe kujdeset për përsosjen e saj. E shqyrton edhe suksesit në nivel të vitit, bashkëpunon me Këshillin e prindërve për zgjidhjen e çështjeve lidhur me suksesin dhe sjelljen e nxënësve.
<b>7.3. Këshilli i paraleles</b>	e përbëjnë arsimtarët të cilët realizojnë procesin mësimorë dhe bashkëpunëtorët profesional. Ata drejtpërdrejtë e organizojnë dhe realizojnë punën edukativo arsimore dhe kujdesen për përsosjen e saj.
<b>7.4. Aktivat profesionale</b>	i përcaktojnë bazat për Planin vjetor si dhe e harmonizojnë punën e arsimtarëve prej lëndëve të njëjta ose të ngjashme. Qëllimet dhe detyrat e aktivëve, grupeve punuese janë dhënë në shtojcat.nr.8
<b>7.5. Kujdestari i paraleles</b>	zgjidhet nga radhët e arsimtarëve që realizojnë mësimin në klasë. Ai e përcjell punën dhe disiplinën në klasë dhe kujdeset për realizimin e rregullt të procesit mësimorë, për rregullsinë e nxënësve dhe për arritjen e sukseseve më të larta (shtojca nr.15 – programi i punës së kujdedst. të klasës).
<b>7.6. Bashkëpunëtorët profesional</b>	secili prej aspektit të tij angazhohet për përmirësimin e kusahteve dhe rezultateve të punës edukativo arsimore në shkollë dhe për punën e programit të tij (shtojca 9 dhe 10 – programi për punën e pedagogut,psikologut, bibliotekistit).
<b>7.7 Këshilli menaxhues</b>	i shkollës është një organ profesional të cilin e përbëjnë drejtuesit e aktivave profesionale, drejtori, pedagogu dhe psikologu. Ai ka për detyrë: <ul style="list-style-type: none"> <li>- të hulumtoj mundësinë për organizim dhe realizim më racional të procesit mësimorë dhe aktiviteteve jashtë mësimore në shkollë;</li> <li>- të hulumtoj mundësinë dhe dinamikën për format dhe metodat e reja si dhe të mjeteve të reja për procesin arsimorë;</li> <li>- e shqyrton metodologjinë dhe instrumentet për vlerësimin e punës së arsimtarëve dhe shkollës;</li> <li>- E përcakton metodologjinë për programimin e punës së shkollës dhe në planifikimin e punës së arsimtarëve</li> </ul>
<b>VIII BASHKËPUNIMI I SHKOLLËS</b>	
<b>8.1. Bashkëpunimi me familjen</b>	Procesi arsimor i adoleshencës është i pakonceptueshëm pa bashkëpunim të përhershëm, të ngushtë, të hapur dhe të plotë me prindërit ose familjen e studentit. Isshtë familja ajo që i ka besuar anëtarit të saj të jetë pjesë e shkollës sonë dhe natyrisht, ajo duhet të ketë të drejtën e patjetërsueshme për komunikim,



	<p>bashkëpunim, informacion për gjithçka që ndodh në shkollë.  Ky bashkëpunim, komunikim në kuptimin më të gjerë të fjalës mundësohet përmes formave dhe formave të ndryshme, duke filluar nga takimet e prindërve, pranimi i prindërve në një kohë të caktuar, përfshirja e prindërve në menaxhimin e shkollës, bashkëpunimi profesional me ta, përfshirja e prindërve në arritjen e qëllimeve të shkollës, ahengje të përbashkëta, festime, prezantime dhe sporte kulturore apo ngjarje shkencore. Bashkëpunimi do të realizohet përmes këshillimit individual dhe grupor të prindërve, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Këshillimin e Prindërve dhe Studentëve. (Shtojca Nr. 19)  Nëse mësimi realizohet në internet, atëherë shkolla do të sigurojë kushte për zhvillimin e një takimi prindër duke përdorur teknologjinë dixhitale.</p>
<p><b>8.2. Bashkëpunimi me institucionet dhe organizatat</b></p>	<p>Këtë vit shkollor do të vazhdojmë me bashkëpunimin me institucionet që ngudht janë të lidhura me punën tonë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Ministria e arsimit dhe shkencës së Maqedonisë</li> <li>- Qyteti i Shkupit – Sektori për arsim</li> <li>- Enti për zhvillim të arsimit</li> <li>- Inspektorati shtetërorë i arsimit</li> <li>- qendra shtetërore e provimeve</li> <li>- inspektorati drejtues shtetërorë</li> <li>- agjencioni për mbrojtjen e të dhënave</li> <li>- Agjencioni për rini dhe sport</li> <li>- Qyteti i Shkupit – Sektori për sport</li> <li>- USAID, MCGO</li> <li>- Të gjitha shkollat fillore dhe të mesme të qytetit të Shkupit dhe më gjerë</li> <li>- Fakulteti i Makinerisë,. Elektros dhe i Filozofisë, Fakulteti i Farmacisë, filologjik, ekonomisë, drejtësisë dhe Universitete tjera private të qytetit.</li> <li>- Muzeu i Maqedonisë, Muzeu i arkeologjisë, Muzeu i qytetit të Shkupit, Muzeu i arteve moderne, Muzeu i VMRO-së dhe Muzeu i holokaustit</li> <li>- Organizatat joqeveritare</li> <li>- Kryqi i Kuq i Maqedonisë</li> <li>- Enti për mbrojtje shëndetësore i Shkupit</li> <li>- Qendra shtetërore e provimeve - QSHP</li> <li>- Agjencioni kombëtarë për projekte arsimore dhe mobilitet etj.</li> <li>- EAC Educational Advising Centar (Maja Petrushevska)</li> <li>- Ministria për punë dhe politikë sociale</li> <li>- Teknika popullore e Maqedonisë</li> <li>- Këshilli republikan për siguri të komunikacionit dhe rrugëve</li> </ul>

<p><b>8.3. Bashkëpunimi ndërkombëtarë</b></p>	<p>Qëllimi i bashkëpunimit para se gjithash është shkëmbimi i përvojave nga puna edukatvo arsimore, shkëmbimi i vizitave të nxënësve dhe arsimtarëve, komunikimi përmes internetit, ndihma në organizimin e ligjëratave dhe seminareve për të punësuarit e shkollës në këto shtete, organizimi dhe realizimi i ngjarjeve të përbashkëta sportive, lojërave dhe garave, me qëllim të avansimit të bashkëpunimit, shkëmbimit të kulturës së jetës, traditave etj.</p> <p>Shkolla ka realizuar bashkëpunim edhe me shkollat e R. Francës, Shqipërisë, Bullgarisë dhe Romanisë, B e H, Mali i Zi, Bratanisë</p> <p>Bashkëpunimi mne shkollat nga shtetet tjera</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Gjimnazi “Bodler” nga Rube, Francë,</li> <li>-Gjimnazi “Morandier” nga Granvill, Francë,</li> <li>-Gjimnazi “Nehemija” nga Pogradeci, Shqipëri,</li> <li>-Gjimnazi “Branko Veanu” nga Bukureshti, Romania,</li> <li>-Gjimnazi “Shën Ivan Rillsko” nga Sofja, Bullgari.</li> <li>-Gjimnazi “Jane Sandanski” nga Sandanski, Bullgari,</li> <li>-Gjimnazi “Tomas Xheferson” nga Sofja, Bullgari,</li> <li>- Gjimnazi i pestë nga Sarajeva – R. B e H,</li> <li>- Gjimnazi nga Bari - R. Mali i Zi,</li> <li>- Gjimnazi nga Piteshtani – R. Romanisë</li> <li>- Gjimnazi „Mihajlo Pupin “ nga Beogradi – Serbi</li> <li>-Shkolla „Peter-Wisse Gesamtshule”od Una, R. Gjermanisë</li> <li>-Shkolla Catholic High schooland Sixt Form Colages, Lids, Britani</li> <li>-Gjimnazi nga Piroti, Serbi</li> <li>-Rjeti i shkollave në suaza të projektit „Susret Evropskih gimnazija”</li> <li>-18 Gjinazi Zagreb Kroaci</li> </ul> <p>Shkolla Pomorska</p> <p>Aktivitete në suaza ERAZMUS + (KA 2)</p> <p><b>Bashkëpunim me EFIS –shkolla internacionale franceze (shkollë fillore)</b></p> <p>Planifikohet edhe bashkëpunimi ndërkombëtarë që të vazhdoj me këto shkolla dhe të zgjerohet edhe shkolla tjera nga shtetet tjera të rajonit.</p> <p>Nëse mësimi realizohet online, atëherë shkolla do të sigurojë kushte për zbatimin e projekteve duke përdorur teknologjinë dixhitale.</p>
<p><b>IX. RENDI I SHTËPISË SË SHKOLLËS</b></p>	<p>Në shkollë ekziston Rendi i shtëpisë dhe Kodi për sjellje të nxënësve, arsimtarëve dhe prindërve. Orët hyrëse në fillim të vitit shkollor do ti kushtohen përvetësimit të këtyre rregullave dhe implementimit të tyre në jetën dhe punën e përditshme të shkollës.</p>

	<p>Do të punohet në implementimin e përmbajtjeve të:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kodit për sjelljen e nxënësve</li> <li>- Kodin për sjelljen e arsimtarëve</li> <li>- Kodin për sjelljen e prindërve</li> <li>- Kodin për sjelljen në klasë me kompjuterët, bibliotekë, sallën sportive, oborrin e shkollës</li> <li>- Rregullore për bashkëpunim me shërbimin për sigurim të shkollës</li> <li>- Rregullore për shqiptim të masave pedagogjike</li> <li>- Rregullore për zgjedhjen e nxënësit më mirë të gjeneratës</li> <li>- Kodi për ballafaqim me dhunën</li> <li>- Rregullore për ballafaqim gjatë shfrytëzimit SPA (Shtojca numër 11)</li> </ul>
--	--

Si shtojcë e këtij programi vjetor janë këto programe:

Shtojca nr.. 1: Programi „Integrimi i edukimit ekologjik në sistemin arsimorë të Maqedonisë”

Shtojca nr.. 2: Plani i aktiviteteve për inzegrim multitetnik në sistemin arsimorë

Shtojca nr. 3: Programi për punën në suaza të projektit „Shkolla të sigurta – mjedis harmonik”

Shtojca nr.. 4: Kalendar i punës

Shtojca nr.. 5: Programi për punën e drejtorit

Shtojca nr.. 6: Programi për punën e kujdestarëve të proc. mësimorë

Shtojca nr.. 7: Programi për punën e Këshillit shkollorë

Shtojca nr.. 8: Programi për punën e aktivëve profesionale

Shtojca nr.. 9: Programi për punën e shërbimit pedagogjik - psikologjik

Shtojca nr.. 10: Programi për bibliotekën

Shtojca nr.. 11: Rendi i shtëpisë së shkollës

Shtojca nr.. 12: Programi për punën e Bashkësisë së nxënësve dhe Parlamentit të nxënësve

Shtojca nr.. 13: Rregullore për ekskurzione

Shtojca nr.. 14: Programi për punën e Qendrës për zhvillim të karrierës

Shtojca nr.. 15: Programi për punën e Kujdestarit të klasës

Shtojca nr. 16 Zhvillimi profesional i drejtorit dhe i arsimtarëve

Shtojca nr. 17 Program për punën e këshillit të prindërve  
Shtojca nr. 18 Program dhe protokollo për nxënësit me nevoja të posaçme  
Shtojca nr. 19 Program për këshillim me prindërit

### **Dispozita përfundimtare**

Ky Program hyn në fuqi ditën e sjelljes.

Numër \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_ viti 2022  
Shkup

СОВЕТ НА ГРАД СКОПЈЕ  
K Ë S H I L L I I QYTETIT TË SHKUPIT  
ПРЕТСЕДСАТЕЛ , KRYETAR,  
Трајко Славевски Трајко Sllavevski